



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË
KAVAJË

Adresa: Bulevardi "Josif Budo"

Lgj. Nr.1 Kavajë

Kavajë, më 04/03/2016

VENDIM
NR. 11 DATË 04.03.2016

Ne mbledhjen e rradhes, Keshilli i Bashkise Kavaje mori ne shqyrtim Projekt-Vendimin e paraqitur nga, Drejtoria e Kulturës dhe Sportit me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 54, gërma "m" e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligjin Nr. 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" dhe,

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit "**Qytetar Nderi (pas vdekjes)**" **Z. Agron SHEHI** me motivacionin "Për kontributin e shquar në fushën e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerrë breza të tërë nxënësish dhe duke përçuar kulturë në qytetin e Kavajës.
2. Dhënien e titullit "**Qytetar Nderi (pas vdekjes)**" **Z. Ismail BIZHUTA** me motivacionin "Për kontributin e shquar në fushën e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerrë breza të tërë nxënësish dhe duke përçuar kulturë në qytetin e Kavajës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve dhe Drejtoria Ligjore dhe e Shërbimeve Mbështetëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefektura Tiranë.

SEK. KËSHILLIT BASHKIAK

Valbona MUSTAFA

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

Aqif PEZA



RELACION

Drejtoria e Kulturës dhe e Sporteve, mbështetur në nenin 54, gërma “m” e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në Ligjin Nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, i kërkon Këshillit të Bashkisë Kavajë që në mbledhjen e tij të rradhës, të miratojë këtë projekt vendim si me poshtë vijon:

Në kuadër të Festës së “7 Marsit”, Dita e Mësuesit, e cila shënohet si një ngjarje me rëndësi kulturore në gjitha trojet tona shqiptare.

Në këtë ditë ne të gjithë së bashku kujtojmë mësuesit tonë të parë që na mësuan shkronjat shqipe, na mësuan se si ta duam dhe ta respektojmë atdheun. Na mësuan poezitë e bukura të autorëve tanë të mrekullueshëm që çdo fjalë e varg i saj të mbetet e të ngulitet thellë në mendjet tona.

Me aq dashuri e respekt janë sjellur me ne për të na mësuar e kritikuar me atë metodën dashamirësisë kur ne bënim gabime. Mësimet e mësuesve tanë u bënë udhërrefyes për rrugën tonë në të ardhmen. Ato mesime na ndjekin edhe sot që kemi dalë në jetën tonë të pavarur. Le t'ua dedikojmë suksesin tonë në jetë mësuesve tanë.

Për këtë arsye, kërkojmë të jepet titulli “Qytetar Nderi (pas vdekjes)” me motivacionin: *Në kuadër të festës së “7 Marsit” ditës ndërkombëtare të mësuesit. Per kontributin e dhene ne fushen e arsimit dhe mësuesisë, duke nxjerrë breza të tërë nxënësish dhe duke përcuar kulturë në qytetin e Kavajës për:*

- ❖ **Agron SHEHU** – I cili ka një karrierë të gjatë si mësues “Gjuhë Letërsie”, ka dhënë mësim ne fshatin “Bago” dhe “Synej” gjatë karrierës së tij ka qënë dhe Drejtor i shkollave në të cilat ka punuar.

QYTETAR NDERI (pas vdekjes)

- ❖ **Ismail BIZHUTA** – I cili ka një karrierë të gjatë si mësues “Matematikë- Fizikë”, ka dhënë mësim në disa shkolla të qytetit si në: Shkollën “3 Dëshmorët”, “Rilindja” dhe “ Kanaparje”. Ai ka qënë Drejtor dhe nën drejtor në këto shkolla

QYTETAR NDERI (pas vdekjes)

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Drejtoria e Kulturës dhe e Sporteve

Erjon LALAJ

